

## **Permbledhje rreth tumoreve ne Shqiperi.**

### **Situata epidemiologjike, barra ne sherbimet shendetsore dhe masat e marra**

**2020**

#### **Mesazhe të përgjithshme për kancerin**

- Kanceri është një sëmundje që nuk njih kufij dhe mund të ndikojë te të gjithë ne, në mënyrë direkte apo indirekte përgjatë jetës sonë.
- Veprimet e ndërmarra nga çdo person, organizatë dhe qeveri do të ndihmojnë për të zvogëluar barrën e sëmundjes së kancerit, për të arritur uljen me 25% të vdekjeve të parakohshme nga sëmundjet kronike deri në vitin 2025.
- Kanceri është një nga shkaqet kryesore të vdekjeve në mbarë botën, përgjegjës për 8.2 milionë vdekje në vit. Megjithatë, ne e dimë se më shumë se 1/3 e këtyre vdekjeve janë të parandalueshme, dhe shumë lloje kanceri nëse zbulohen herët janë të shërueshëm.
- Derisa ndërgjegjësimi për kancerin të përmirësohet globalisht, si dhe të ndërmerren veprime të nevojshme për parandalimin dhe trajtimin e kësaj sëmundjeje, miliona njerëz në mbarë botën do të vdesin çdo vit.
- Ne duhet të veprojmë tani për shkak se epidemia globale e kancerit është e madhe dhe po rritet. Parashikohet që të kemi një rritje me 19.3 milionë raste në vit deri në vitin 2025 krahasuar me 14.1 milionë në vitin 2012.

#### **Situata ne vendin tone**

Bazuar ne te dhenat e regjistrimit kombetar te kancerit, cdo vit ne Shqiperi shfaqen rreth 6000 raste te reja me tumore. Ato shkaktojne mbi 16% te te gjitha vdekjeve (shkaku i dyte kryesor pas semundjeve kardiovaskulare). Cdo vit prej tumoreve humbin jeten mbi 3600 persona. Rreth 10% e vdekjeve nga tumoret jane nen moshen 50 vjec.

Tumoret me te shpeshta jane tumori i mushkerive me rreth 800 raste te reja per 2018 dhe tumori i gjirit me rreth 700 raste ne 2018.

Prirja e tumoreve ne sistemin shendetsor shqiptar ka qene ne rritje 3 gjate dekadave te fundit, kryesisht per arsye te rritjes se moshes mesatare te popullates, por edhe per shkaqe te tjera te lidhura me stilin e jeteses apo mjedisin. Kjo prirje eshte shprehur sidomos ne nivelin e perdorimit te sherbimeve shendetsore lidhur me semundjet tumorale.

Prirjet ne kohe te incidences per lloje te ndryshme te tumoreve nuk jane te njejta. Keshtu tumori i gjirit dhe tumori kolorektal (zorra e trashe) duket se kane qene ne rritje, nderkohe qe tumori i stomakut apo ai i mushkerive, megjithese tradicionalisht mjaft te shpeshte ne vendin

tone nuk janë duke u rritur. Keto dhe prirje të tjera mes tumoreve janë të ngjashme me profilet globale të këtij problemi shëndetsor.

Nderkohe, prirjet e nivelit të vdekshmërisë për shumicën e dermuesve të kancerëve nuk janë në rritje prej disa vitesh.

Risku për tu prekur dhe për të vdekur nga tumoret është shumë më i lartë tek meshkujt në moshat mbi 65 vjeç, por e kundërta vëhet re në moshat nën 65 vjeç. Me përjashtim të tumoreve të organeve riprodhuese femërore, vdekshmëria nga tumoret e tjera është me të shpeshtë mes meshkujve. Diferenca mes meshkujve dhe femrave ka ardhur duke u zvogëluar nga viti 2012 në vitin 2018.

Tumoret, kanceret, neoplazmat janë terma të përgjithshëm për një grup të madh sëmundjesh; ka më shumë se 100 lloje të tumoreve, me shpeshësi të ndryshme në popullatë dhe me faktore të ndryshëm rrisht. Vlerësohet se shumica e tumoreve janë të shkaktuar nga (a) ushqyerja e gabuar (pak fruta perime, shumë yndyrna dhe produkte shtazore, kripa, alkoli, obeziteti etj) (b) duhanpirja, (c) agjentet infektive (d) sedentarizmi (e) ndotjet mjedisore, etj.

Ministria e Shëndetësisë në luftën kundër tumoreve ndjek Planin Kombëtar kundër Tumoreve 2011-2020, i cili parashikon masat në katër fusha kryesore; a) parandalimit primar, b) depistimit apo kapjes së hershme, c) diagnozës dhe trajtimit dhe d) kujdesit paliativ

Është për t'u mbajtur parasysh se disa prej masave në luftën kundër tumoreve i japin efektet e tyre në një distancë të konsiderueshme kohore nga momenti i fillimit të aplikimit në praktikë.

### ***1. Në fushën e parandalimit primar ndër masat kryesore janë:***

- Lufta kundër duhanit e cila është duke rezultuar e sukseshme në kontrollin e duhanpirjes në publik dhe ka filluar të shprehet edhe në frenimin e rritjes së duhanpirjes në popullatë mes meshkujve adultë. Efektet e saj në shëndet kanë filluar të ndihen sidomos tek sëmundjet kardiovaskulare, por do të ndihen shpejt edhe tek sëmundjet tumorale, sidomos tumorin e mushkerive
- Informimi dhe ndergjegjësimi i publikut mbi ushqyerjen e shëndetshme (dhe elemente të tjera të stilit të shëndetshëm të jetesës) është duke u bërë me sistematik si në shkollë ashtu edhe në popullatën e përgjithshme
- Vaksinimi kundër hepatitit B është duke u realizuar me sukses në fëmijet dhe në të gjitha grupet me rrisht të popullatës.

### ***2. Në fushën e depistimit/kapjes së hershme (vetëm tre tumore parashikohen si shkancerisht të parandalueshëm përmes depistimit, bazuar në strategjinë e Bashkimit Europian në fushën e kontrollit të tumoreve) :***

- Fillimi i depistimit të organizuar për tumorin kolorektal përmes testit të gjakut okult në fecë, si pjesë e programit të kontrollit baze shëndetsor (2015). Me qindra mijëra persona janë duke përfituar prej këtij programi.

- Intesifikimi i mbeshtetjes së shërbimeve të kapjes së herëshme të tumorit të gjirit përmes njesive të levizeshme mamografie dhe mamografive të reja fikse duke e dyfishuar numrin e mamografive të kryera në vend për qëllime depistimi (2015-2018). Gjithashtu është përgatitur nga ISHP dhe miratuar nga Ministria, udhërefyesi kombëtar i diagnozës së herëshme pranë shërbimeve të kujdesit shëndetsor përsos (2015), dhe është duke u përgatitur plani për një program kombëtar bazuar në mamografine për këto vit.
- Fillimi depistimit të organizuar për tumorin e qafes së mitres përmes testimit për HPV (VKM 29 Janar 2019)

### ***3. Në fushën e diagnozës dhe trajtimit:***

- Heqja e barrierave financiare dhe administrative për gjithë shërbimet shëndetsore të diagnozës dhe trajtimit për tumoret për gjithë popullatën (Urdhër Ministri 2014). Me qindra qytetare janë duke përfituar nga kjo masë.
- Rritja e rëndësishme e financimit për barnat e këmioterapise dhe hormonoterapise me synim mbuliminë gjithë pacientëve të diagnozuar me trajtimin e duhur baze.
- Investimi në qendren e re të radioterapise dhe futja e një shërbimi të ri modern të radioterapise me më pak efekte anësore (Akseleratori Linear 2016). Një teknologji e re radioterapie akoma më e avancuar (radioterapi e asistuar nga imazheria- IMRT) është siguruar dhe pritet të fillojë nga puna brenda disa muajsh.
- Ka ardhur duke u rritur në vazhdimësi volumi i shërbimit kirurgjikal për tumoret në QSUT.

### ***4. Në fushën e kujdesit paliativ:***

- Është miratuar ligji mbi kujdesin paliativ (2014) dhe janë duke u mbështetur disa shërbime në disa spitale rajonale në këto fushë

## Te dhena mbi tumoret ne Shqiperi

### Ceshte tumori

‘Tumori’ eshte nje term i pergjithshem qe perdoret per nje grup me me shume se 100 semundje, te cilat mund te prekin çdo pjese te organizmit. Terma te tjere, te cilet perdoren per keto semundje, jane ‘tumore malinje’ dhe/ose ‘neoplazma malinje’. Tumoret e ndryshme te njeriu jane semundje, ne te cilat, nje nga qelizat e shumta nga te cilat eshte ndertuar organizmi, alterohet ne nje menyre te tille qe riprodhon veteveten duke prodhuar miliona qeliza te alteruara veteriprodhuese, disa prej te cilave mund te transferohen ne pjese te tjera te trupit dhe mund ta shkaterrojne ate. Qelizat e tumorizuara humbasin specializimin e indit qe i perkasin dhe nuk i pergjigjen mekanizmave te kontrollit qe normalisht kufizojne ndaljen e qelizave.

### Vdekshmeria nga tumoret bazuar ne skeden e vdekjeve

#### Vdekshmeria nga tumoret ne vite

(numri bruto i vdekjeve per 100,000 banore)							
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
<b>Meshkuj</b>	161.8	156.2	164.4	158.8	153.7	155.6	165.0
<b>Femra</b>	95.5	90.9	97.0	96.0	93.9	97.7	92.9
<b>Total</b>	128.9	123.8	131.1	127.8	124.2	126.9	129.0


Ne vitin 2018 u regjistruan 3641 vdekje nga semundjet tumorale apo kanceret ne Shqiperi ose 126.7 per 100000 banore. Nga keto 851 (29.6/100000) ishin vdekje nga tumori i mushkerive, 376 (13.1/100000 banore) vdekje nga tumori stomakut, 270 (9.4/100000 banore) vdekje nga tumori i melcise, 233 (16.4/100000 femra) vdekje nga tumori i gjirit, 213 (7.4/100000) vdekje nga tumori i zorres se trashe, 211 (14.6/100000 meshkuj) vdekje nga tumori i prostates, 170 (5.9/100000) vdekje nga leukozat e limfomat malinje, 39 (2.7/100000 femra) vdekje nga tumori i qafes se mitres, 37 (1.3/100000) vdekje nga melanoma malinje. Pjesa tjeter e vdekjeve ne kete kategori jane nga tumore te tjere me letalitet ose incidence me te ulet.

### Vdekshmëria nga tumore të organeve të veçanta dhe pesha specifike e secilit ndaj totalit


Shkaqet e vdekshmërisë nga tumore të organeve specifike	Niveli bruto i vdekshmërisë /100 000	Pesha specifike në % ndaj totalit
Mushkëria	29.6	23.4%
Gjiri	16.5	13.0%
Prostata	14.6	11.5%
Stomaku	13.1	10.3%
Mëlçia	9.4	7.4%
Zorra e trashë	7.4	5.8%

Leukozat dhe limfomat malinje	5.9	4.7%
Qafa e mitrës	2.7	2.1%
Melanoma malinje	1.3	1.0%
Të tjerë	26.2	20.7%
<b>Tumoret në total</b>	<b>126.7</b>	<b>100.0%</b>

### Krahasimi i vdekshmerise nga tumoret dhe prirjeve te saj me vende te rajonit



### Prirjet e vdekshmerise bruto dhe asaj te standartizuar ne vite (vdekshmeria e standartizuar menjanon efektin e ndryshimit te moshes)



## **Incidenca bazuar ne regjistrin kombetar te tumoreve**




Verehet se tumoret me numer me te shpeshte te rasteve te reja te diagnostikuara ne vendin tone, jane tumori i mushkerive, tumori i gjirit dhe tumoret e lekures. Keto zene mbi 25% te te gjithë tumoreve te reja te raportuara nga sistemi shendetesor.




Tumore te tjera te shpeshta ne Shqiperi jane ato te zorres se trashe, te stomakut, te vezikes urinare, te mitres, te sistemit nervor qendror, te gjakut dhe sistemit hemopoetik, te ezofagut, , fytit dhe gojes. Krahasimisht me te rralla se ne vende te tjera te Europes, ne vendin tone jane tumoret e prostatës apo melanomes me me pak se 2% te totalit te tumoreve. Shume tumore te tjera zene vetem me pak se 1% e totalit te kancereve.

### **Raste e reja me tumore sipas grup moshes. 2018**

<b>Grup- Moshë</b>	<b>Raste te reja ne vit</b>
0-9	61
10_19	68
20-29	101
30-39	240
40-49	597
50-59	1362
60-69	1856
70-79	1356
80+	506
<b>Total</b>	<b>6147</b>

## Prirjet e shtrimeve ne spital per disa tumore kryesore





**Prevalenca e** regjistruar ne sistemin shendetesor (persona qe jetojne me kancer dhe jane te regjistruar ne sistemin shendetesor)

**Prevalenca (raste per 100,000): , 2008-2018**

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
<b>Tumore /100 000</b>	345	379	426	425	504	510	516	559	614	625	647



Faktoret e njohur te riskut per kanceret ne Shqiperi. Vleresim 2015

